TAKIMI I PARË 2026 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Takimi i parë i Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u zhvillua në datë **31.03.2026.**

Mbledhja u hap me fjalën përshëndetëse, ku u theksua rëndësia e sektorit të turizmit në zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojën për angazhim të shtuar nga institucionet dhe aktorët përkatës. U vlerësua kontributi i anëtarëve të Komitetit Sektorial në pasurimin e ofertës së kualifikimeve profesionale në fushën e mikpritjes dhe turizmit, përmes përditësimit të kompetencave, integrimit të elementeve teknologjike dhe ekonomisë së gjelbër, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në pjesën e parë të takimit u prezantuan proceset aktuale të AKAFPK-së për zhvillimin e ofertës së kualifikimeve profesionale. Sekretariati Teknik informoi anëtarët se, kishte nisur procesi i hartimit të standardit të profesionit për kualifikimin e nivelit V: "*Menaxher i Operatorit Turistik*" dhe pas përfundimit të tij do të vijonte hartimi i standardit të kualifikimit profesional. Sekretariati Teknik bëri me dije gjithashtu se, në mbledhjen e ardhshme synohej validimi i të dy dokumenteve përkatëse.

Në vijim të agjendës, Sekretariati Teknik prezantoi anëtarët me strukturat ekzistuese të ofrimit të kualifikimeve profesionale sipas drejtimeve përkatëse. U shpjegua struktura 4-vjeçare, 3+1, 2+2 dhe 2+1+1, si dhe daljet përkatëse në tregun e punës për secilën. Më tej, Sekretariati Teknik prezantoi kualifikimet profesionale ekzistuese në fushën e Hoteleri - Turizmit, strukturën e ofrimit për secilin, certifikatën e kualifikimit dhe daljen në tregun e punës.

Në vazhdim të kësaj, Sekretariati Teknik informoi anëtarët se, nisur nga takimet e përvitshme që AKAFPK bënte me shkollat e mesme profesionale publike, rezultonte se, nxënësit nuk e ndërprisnin arsimin pas dy viteve të para për t'u punësuar si ndihmës në tregun e punës, por vijonin studimet drejt niveleve më të larta të kualifikimit (III ose IV). Gjithashtu, nga kontaktet e vazhdueshme me bizneset që operojnë në fushë, rezultonte se tregu i punës i mbulonte nevojat për ndihmës kryesisht me punonjës të pakualifikuar ose punonjës të kualifikuar me kurse afatshkurtra, ndaj nuk lindte nevoja për të akomoduar nxënësit që përfundonin nivelin e II të KSHK-së. Nisur nga sa më sipër, kualifikimi profesional aktual dy vjeçar i përgjithshëm ***"Hoteleri-Turizëm"*** nuk po rezultonte efektiv në aspektin e punësimit të menjëhershëm të të diplomuarve. Në këtë kuadër, lindte nevoja për rishikimin e strukturës së ofrimit të kualifikimeve profesionale ekzistuese.

Anëtarët diskutuan dhe dakordësuan që kualifikimet profesionale të ofroheshin me kohëzgjatje 3 ose 4 vjeçare bllok, pasi kjo do i shërbente bizneseve duke i pasur nxënësit më shumë kohë në praktikë dhe përgatitjes së forcës punëtore më të kualifikuar dhe të profilizuar thellësisht.

Me qëllim integrimin e të diplomuarve në tregun e punës dhe përmbushjen e nevojave të sektorit, anëtarët propozuan ofrimin e tre kualifikime profesionale në formën 3-vjeçare bllok: ***"Kuzhinë - pastiçeri"***, ***"Shërbime hoteliere në struktura akomoduese"*** dhe ***"Shërbim ushqimi dhe pije"***. Propozimet u miratuan në parim dhe u dakordësua që emërtimet përfundimtare të diskutohen më gjerësisht në takimet e ardhshme.

Lidhur me kualifikimin profesional ***"Pastiçeri"***, anëtarët vlerësuan se duhej të trajtohej si kualifikim më vete dhe duke qenë se, interesi i nxënësve për këtë kualifikim në arsimin e mesëm profesional rezultonte i ulët, propozuan të ofrohej si kualifikim pas të mesëm me kohëzgjatje 1-vjeçare.

Lidhur me kualifikimet profesionale për turizmin, u propozua riorganizimi i kualifikimeve profesionale ekzistuese në një kualifikim të vetëm 4-vjeçar: ***"Shërbime udhëtimi dhe turizmi"***, i cili do të përfshinte edhe kualifikimin profesional ekzistues: ***"Guidë turistike"***. U vlerësua se, kjo strukturë e re do të rriste përgatitjen profesionale dhe mundësitë e punësimit të nxënësve.

Në përfundim, u dakordësua që mbledhja e ardhshme të fokusohej në diskutimin e emërtimeve të kualifikimeve të propozuara dhe krahasimin e tyre me ofertat ekzistuese. Takimi u mbyll me falënderime për pjesëmarrjen dhe kontributin e anëtarëve.

Vendime të marra nga mbledhja:

- U miratua ndryshimi i strukturës ekzistuese të drejtimit Hoteleri - Turizëm nga 2+1+1 dhe 2+2 në struktura 3+1 ose 4-vjeçare bllok.
- U propozua riorganizimi i kualifikimeve profesionale ekzistuese në tre kualifikime 3-vjeçare bllok: ***"Kuzhinë - pastiçeri"***, ***"Shërbime hoteliere në struktura akomoduese"*** dhe ***"Shërbim ushqimi dhe pije"***.
- U propozua riorganizimi i kualifikimeve ekzistuese në turizëm dhe ofrimi i kualifikimit me kohëzgjatje 4-vjet bllok: ***"Shërbime udhëtimi dhe turizmi"***, duke përfshirë edhe kualifikimin profesional ekzistues:*"**Guidë turistike".***
- U propozua ofrimi i kualifikimit profesional ***"Pastiçeri"***, si kualifikim pas të mesëm me kohëzgjatje 1-vit.